



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK TEPELENË

Nr. 189/5 prot.

Tepelenë, më 01 . 02 . 2023

VENDIM
Nr. 5 datë 31 . 01 . 2023
PËR

**SAKTËSIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË NR. 93, DATË
25.11.2022 “PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË ADMINISTRATËS SË
BASHKISË DHE STRUKTURAVE TË TJERA”**

Bazuar në: Nenin 8, Pika 2, Nenin 9, Pika 1/1.1, Shkronja “b”, Nenit 54, Shkronja “ç”, Nenit 55, Pikat 4 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Neni 14 “Kontributet profesionale në planifikim” të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar; Pikën 4 dhe Pikën 7 të Vendimit të Këshillit Bashkiak Tepelenë nr. 93, datë 25.11.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të administratës së Bashkisë dhe Strukturave të tjera”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 656, datë 31.10.2018 “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njëjësive të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar; Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve; Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 430, datë 11.07.2018 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të lejeve (e-Leje)”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, të ndryshuar; Dokumenteve të paraqitura, si dhe Propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak Tepelenë,

V E N D O S I:

1. Saktësimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak Tepelenë nr. 93, datë 25.11.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të administratës së bashkisë dhe strukturave të tjera” si më poshtë vijon:

Pika 4. Të miratojë shpërblimin mujor të Sekretariatit Teknik të Territorit sipas Lidhjes 7.

LIDHJA 7 SHPËBLIMI PËR SEKETARIATIN TEKNIK

Emërtesa e bordit /sekretariatit	Numri i pagesave në vit	Përbërja		Masa e shpërblimit në lekë	
		Kryetari	Nr. Anëtarëve	Kryetari	Anëtar
Sekretariati teknik i Rregullimit të Territorit	12	1	5	25000	20000

Saktësohet në:

4. Të miratojë shpërblimin mujor të Këshillit/Sekretariatit Teknik të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) Tepelenë, sipas Lidhjes 7.

Lidhja 7 - Shpërblimi për Këshillin/Sekretariatit Teknik të DPKZHT-së:

Emërtesa	Numri i pagesave në vit	Përbërja		Masa mujore e shpërblimit në lekë	
		Kryetari	Anëtarë	Kryetari	Anëtar
Këshilli/Sekretariati Teknik i DPKZHT-së	12	1	6	25000	20000

Pika 7. Efektet financiare fillojnë që më 1 shtator 2022.

Saktësohet në:

7. Efektet financiare fillojnë që më 1 shtator 2022. Për pikën 4 efektet financiare fillojnë që me krijimin e Këshillit/Sekretariatit teknik të DPKZHT, por jo më parë se data 25.11.2019.

Pika 1. Lidhja 1 Paga e sekterarit të Këshillit Bashkiak :

Sekretar i Keshillit Bashkiak	II-b	1	2%	46.000
-------------------------------	------	---	----	--------

saktësohet në :

Pika 1. Lidhja 1 Paga e sekterarit të Këshillit Bashkiak :

Sekretar i Keshillit Bashkiak	II-b	1	2%	52.000
-------------------------------	------	---	----	--------

7. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pikës 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar.

Saktësohet në:

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, si dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, si dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Elvis Shehu



SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Valbona Çela

Miratuar me: 13 vota
Vota Pro: 13
Vota Kundër: -
Vota Abstenim: -
Zbardhur më datë: 01.02.2023